



**KOLEGJI I SHKENCAVE MJEKËSORE "REZONANCA"**  
**COLLEGE OF MEDICAL SCIENCES "REZONANCA"**  
**Prishtinë**

Tel: +381 38 544-754  
Fax: +381 38 544-756

URL: <http://www.rezonanca-ks.com>

---

---

Referenca nr.	AD-3160/16
Datë	19.05.2016

### **Kodi i veshjes për sfatin dhe studentët**

Për të ruajtur imazhin e mirë të Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca", e në përputhje me Kodin e Mirësjelljes së Kolegjit, Këshilli Drejtues i Kolegjit vendos Kodin e veshjes për staf dhe studentë, si standard minimal të pranueshëm.

Për vende të caktuara dhe rrethana të veçanta, mund të vendosen standarde shtesë dhe studentët janë të obliguar që të përmbushin këto kërkesa.

Qëllimi i këtij kodi për veshje është që të sigurojë:

1. Identifikimin e lehtë të studentëve derisa janë në lokalet mësimore
2. Paraqitjen e studentëve në një mënyrë profesionale dhe të dinjitetshme
3. Minimizimin e mundësive për lëndime dhe ekspozim ndaj rreziqeve në vendet mësimore
4. Paraqitje të dinjitetshme të stafit akademik

Respektojmë dëshirën dhe preferencat e secilit për veshjen e tij, por për shkak se Kolegji është institucion arsimor-edukativ, dhe për shkak të natyrës së punës specifike në fushat mjekësore, ku mund t'iu nënshtrohen dëmtimeve ose rreziqeve potenciale gjatë punës dhe praktikimit profesional, si dhe punës së ndjeshme me pacientë, jemi të detyruar që të zbatojmë këtë Kod të veshjes në përpikmëri.

Zbatimi i Kodit për veshje do të bëhet nëpërmjet punëtorëve të shërbimit të sigurimit në Kolegj.

Shkeljet e këtij Kodi mund të rezultojnë me një paraqitje për shkelje disiplinore, thyrje të kodit të mirësjelljes, për sjellje të pakënaqshme ose sjellje të keqe.

### **Kodi i veshjes për stafin akademik dhe stafin ndihmës (laborantë, teknikë, etj.)**

- Të gjithë anëtarët e stafit akademik duhet të vijnë në Kolegj me veshje të përshtatshme dhe me një frizurë e cila i jep përshtypjen e rregullsisë dhe të pedantërisë. Ndalohen frizurat ekstravagante.
- Veshja e rekomanduar për meshkuj: këmishë, pantolona, ose kostum meshkujsh dhe kravatë. Veshja e ndaluar: pantolonat e shkurtër; mbathja: sandalet me një gisht.
- Veshja e ndaluar për femra: Fundat e shkurtër (mini fundat), pantolonat e shkurtëra, farmerkat e shqyera, ose me vrime, robot transparente (në raste të tilla nën veshje duhet të mbahet astari, ose nënbluza e pa tejdukshme), bluzat pa mëngë. Mbathja e ndaluar: sandalet me një gisht.
- Gjatë ushtrimeve dhe punës laboratorike duhet të kenë të veshur mantelin e bardhë.

### **Kodi i veshjes për stafin administrativ**

Stafi administrativ duhet të bartë uniformën.

Uniforma për vajza:

- Fundi me ngjyrë të kaltërt
- Këmisha e bardhë
- Shalli me ngjyrë të bardhë ose të kaltërt të qelët

Uniforma për djem:

- Kostum meshkujsh, me ngjyrë të kaltërt të mbyllët
- Këmishë e bardhë
- Kravatë
- Këpucë

Ndalohet arrdhja në punë pa mbathje, ose me sandale me një gisht.

## KODI I VESHJES PËR STUDENTËT

### **Kodi i veshjes për studentët femra:**

Veshja e përshtatshme kërkohet gjatë kohës deri sa jeni brenda lokaleve të Kolegjit, Spitalit, institucioneve arsimore, shëndetësore, dhe institucioneve të tjera, me të cilat Kolegji ka bashkëpunim, dhe në të cilat dërgoheni për mbajtje të mësimi ose për vizita.

Gjatë punës në laboratore, klinika, ushtrime, patjetër, duhet të bartni mantelin e bardhë.

Në ushtrime laboratorike dhe ushtrime klinike femrat me flokë të gjata duhet t'i mbajnë flokët e lidhura gjatë gjithë kohës.

Për ushtrimet në fizioterapi veshja duhet të jetë në përputhje me standardet shitesë, të vendosura nga Departamenti i Fizioterapisë.

Nuk lejohet mbajtja e thonjëve të gjatë, unazave dhe dekorime të tjera në duar.

Sipas paralajmërimeve dhe rekomandimeve për çështje të sigurisë, në punë të caktuara laboratorike ose klinike studentët duhet të bartin syze mbrojtëse, doreza, maska mbrojtëse, përparëse mbrojtëse, apo mjete të tjera për siguri gjatë punës.

Në provime praktike studentët duhet të kenë mantelin e bardhë, kurse në format tjera të vlerësimit duhet të jenë me veshjen e kërkuar sipas kodit standard.

### **Veshjet e ndaluara:**

- Veshjet që vën në dukje barkun, gjoksin, kofshët, ose pjesë të tjera të trupit, të cilat duhet të jenë të mbuluara.
- Veshjet me çarje të theksuar, që zbulojnë në mënyrë të pa përshtatshme pjesë të trupit tuaj.
- Fundat e shkurtër (mini fundat). Fundat duhet të jenë me gjatësi deri te gjuri, ose pak mbi gjunj, me kusht që siguron që gjatë uljes nuk zbulon në mënyrë të pa pranueshme këmbët.
- Pantolonat e shkurtëra. Pantolonat e shkurtëra me gjatësi të këmbëzave deri te gjuri janë të lejueshme.
- Farmerka, pantolona, të shqyera, grisura, me vrima, etj.
- Hellanket janë të lejuara vetëm nëse veshen me bluzë të gjatë, e cila mbahet mbi hellanke dhe mbulon, të paktën, tërë komblikun.
- Roba që janë transparente. Në raste të tilla nën veshje duhet të mbahet astari, ose nënbluza e patejdukshme.
- Bluzat pa mëngë. Gjatësia e mëngëve duhet të jetë sa të mbulojë të paktën 1/2 e gjatësisë së krahut.

- Rrobat tuaja nuk duhet të kenë asnjë foto ose përmbajtje vulgare, fyese apo të turpshme, në cilëndo gjuhë.
- Rrobat e papastërta, me njolla, në gjendje të keqe.
- Mbathja duhet të jetë e përshtatshme, që nuk pengon përmbushjen e objektivave mësimore të kërkuara. Ndalohen sandalet me një gisht.
- Ndalohen stolitë që mund të pengojnë përmbushjen e obligimeve mësimore.

### **Veshjet e ndaluara për studentë meshkuj:**

- Pantollonat e shkurtëra. Lejohen vetëm pantolonat e gjatë deri te këpucët.
- Farmerka, pantolona, të shqyera, grisura, me vrima, etj.
- Rrobat e papastërta, me njolla, në gjendje të keqe.
- Roba që janë transparente.
- Ndalohet bartja e stolive që mund të pengojnë përmbushjen e obligimeve mësimore.
- Veshjet që vën në dukje pjesët e trupit: bluzat pa mëngë. Gjatësia e mëngëve duhet të jetë sa të mbulojë të paktën 1/2 e gjatësisë së krahut.

Zbatimi

Kodi i veshjes fillon së zbatuara nga data 23.05.2016.

REKTORI

Prof.dr.sc. Arian R. Idrizaj, MD, PhD